

Situata aktuale pas aplikimit të
tatimit të sheshtë

Situata aktuale fiskale

- Ka pabarazi të ekzagjeruara në trajtimin e biznesit të vogël në raport me bizneset e tjera duke i trefishuar detyrimet fiskale nga 2007 në 2010.
- Ka rezerva të konsiderueshme në fitimin e kompanive monopol dhe në sektorin bankar, telekomunikacioni dhe të energjisë.
- Tatimi mbi të ardhurat nuk diferencon aspak të ardhurat e individëve dhe duke u kombinuar me tatimet mbi konsumin takson shumë më tepër grupet sociale me të ardhura të ulta ndaj atyre me të ardhura të larta.
- Tatimi i sheshtë nuk të jep mundësi që të shpërndash barrën fiskale si në mes kompanive me madhësi të ndryshme, ashtu edhe kur trajtojmë individët me të ardhura të ndryshme. Tatimi i sheshtë rrit qartazi pabarazinë.

Asfiksimi i Biznesit të Vogël

2007

Taksë e biznesit të vogël



2008

Taksë e biznesit të vogël + Tatim mbi të ardhurat



2010

Taksë e biznesit të vogel + Tatim mbi të ardhurat + Tatim mbi Vlerën e Shtuar*

* - Për subjektet me xhiro nga 5 milionë në 8 milionë lekë të reja

Biznesi i vogël - Nga 2004 nga 2011

- Në 2004 kishte si detyrim një tatim unik mbi xhiron që u ul nga 4% në 3%.
- Në 2005 si pasojë e premtimit elektoral tatimi unik mbi xhiron u ul në 1.5%
- Në 2007 u konvertua në taksë mbi biznesin e vogël me shuma fikse sipas xhiros
- Në 2008 u shtua tatimi mbi të ardhurat (fitimin) në nivelin 10% të xhiros pa hequr taksën e biznesit të vogël
- Në 2008 u shtuan pagat referencë dhe numri i punonjësve referencë për biznesin e vogël
- Në 2010 u ul kufiri i regjistrimit në TVSH për bizneset e vogël nga 8 milionë në 5 milionë dhe u hoq kufiri për profesionet e lira dhe e gjithë kjo duke mbajtur në fuqi taksën mbi biznesin e vogël, pra u përfshinë në skemën e TVSH-së duke sjellë detyrime pranë qeverisë qendrore njësoj si bizneset e mëdha duke ruajtur detyrimin ekzistues pranë bashkisë si biznes i vogël.

Tashmë, prej disa vitesh Biznesi i Vogël paguan tatime të dyfishta e të trefishta.

Biznes i Vogël – Xhiro 7 milionë lekë – Shitje me pakicë ose shumicë

2010 – Total – 338,000 lekë

TVSH

140,000
lekë

2008 – 198,000 lekë

Tatim mbi
të Ardhurat

70,000
lekë

2007 – 128,000 lekë

Taksë e biznesit të
vogël

128,000 lekë

Biznes i Vogël – Xhiro mbi 5 milionë Profesione të lira

2010 – Total – 565,000 lekë

TVSH

400,000
lekë

2008 – 165,000 lekë

Tatim mbi
të Ardhurat

60,000 lekë

2007 – 105,000 lekë

Taksë e biznesit të
vogël

105,000 lekë

Tatimi mbi Fitimin në 2010

20 Kompanitë më të mëdha

- **6 miliardë** lekë tatim mbi fitimin ose 35% të totalit në sistem
- 19 mijë punonjës ose 7% e totalit në sektorin privat (10 mijë pa CEZ dhe Albpetrol).

28 mijë kompanitë e tjera në TVSH

- **7.8 miliardë** lekë ose 45% të totalit
- 180 mijë punonjës ose 69% e totalit në sektorin privat

55 mijë bizneset e vogla

- **3 miliardë** lekë ose 17% të tatimit mbi fitimin
- 60 mijë punonjës ose 23% e totalit
- Ngarkesë shtesë me **2.3 miliardë** lekë si taksë për biznesin e vogël

Tatimi mbi Fitimin

- Tatimi i sheshtë spostoi barrën fiskale nga tatimi mbi fitimin tek tatimi mbi të ardhurat personale
- 20 kompanitë që fitojnë më shumë kanë një shkallë të ulët punësimi dhe kanë përfituar në mënyrë maksimale duke pasur 35% të fitimit dhe vetëm 7% të punësimit (3.5% të punësimit pa CEZ dhe Albpetrol, ish kompani publike).
- Shtesa e tatimit mbi fitimin vetëm mbi 20 kompanitë më të mëdha mund të çlirontë lehtësi fiskale shumë të rëndësishme për 55 mijë biznese të vogla si në tatimin mbi të ardhurat ashtu edhe në taksën e biznesit të vogël, meqë 6 miliardë paguajnë (me 10%) kompanitë e mëdha dhe 5.3 miliardë paguajnë detyrim të kombinuar grupi i bizneseve të vogla.
- 20 bizneset me fitim më të madh kanë kursyer mbi 5 miliardë lekë çdo vit pas 2007 dhe kjo nuk ka sjellë asnjë efekt në punësim, por thjesht është rikuperuar me vështirësi duke shtuar tatimin mbi të ardhurat personale të individëve dhe të biznesit të vogël.
- Tatimi i sheshtë nuk solli lehtësi në punësimin e të papunëve, përkundrazi solli kosto tatimore shtesë për pagat e ulta dhe për bizneset e vogla.

Tatimi mbi të ardhurat personale në ekstreme

- Një pagë e një drejtori të përgjithshëm të një banke në Shqipëri do të taksohej si në vitin 2007, atëherë 200 punonjës me paga minimale nuk do të taksoheshin aspak dhe në fund të vitit do të kishin secili nga 12,000 lekë të çliruara për të shpenzuar në një vit.
- Nëse 100 pagat më të larta të menaxherëve dhe drejtuesve të kompanive kryesore do të taksoheshin si në 2007, atëherë 20,000 punonjës që marrin paga minimale në Shqipëri nuk do të paguanin tatim mbi të ardhurat personale dhe do të kishin të çliruara nga 12,000 lekë në vit.

Transferimi i tatimit nga pagat më të ulta tek ato më të larta

Paga maksimale

Paga maksimale e kompanive më të mëdha është rreth 2,000,000 lekë në muaj pas 2008 dhe ka një tatim prej 10% ndërsa në vitin 2007 kanë paguar një tatim me normë 20%.

Në sistemin e deklarimit të të ardhurave personale ka rreth 100 drejtues (kryesisht të huaj) kompanish kryesore që marrin paga mesatarisht 2 milionë lekë në muaj.

Paga minimale

Paga minimale është 20,000 lekë dhe ka një detyrim mujor prej 1,000 lekë në muaj, ose 12,000 lekë në vit.

20,000 punonjës me paga minimale do të kursenin 12,000 lekë në vit nëse tatimi i tyre do të shkëmbehej me tatimin e pagave të drejtuesve më të lartë të kompanive sipas nivelit të vitit 2007.

Dy argumente plus në fund

- Normat progresive stimulojnë edhe rritjen e aktivitetit të konsumit në një ekonomi. Me rritjen e të ardhurave apo fitimeve, prirja për konsum do të bjerë. Disa nga kompanitë e mëdha të huaja në Shqipëri kanë me qindra milionë Euro para që nuk i përdorin. Ky është një tjetër fakt që vërteton argumentin që kërkesa në një ekonomi nxitet duke reduktuar barrën fiskale mbi të ardhurat e ulta dhe duke rritur barrën mbi të ardhurat e larta.
- Progresiviteti ka efekte pozitive në punësim, meqënëse punësimi rishtazi është më i domosdoshëm për të punësuarit me paga të ulta që favorizohen nga një sistem i tillë. Tatimi i sheshtë shton një barrë të pashmangshme në punësimin e kompanive, sepse kostot shtohen dhe janë të larta edhe për pagat e ulta që mund të ofrohen.